

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Këshilli Bashkiak fton Veliajn në mbledhje - Kërkesë SPAK-ut dhe Burgjeve për pjesëmarrjen
ADRESA	https://www.gazetatema.net/sociale/keshilli-bashkiak-fton-veliajn-ne-mbledhje-kerkese-spak-ut-dhe-burgjeve--i588320
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	25 shtator 2026, 11:50:12 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	25 shtator 2026, 11:50:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	116636cc410dfef5abf8803b73397c050893dd4db106fbf7d59edc2a38e5ff9a
TEKSTI	43db79f50c7eb11b8f035852aac840505664c64cef89b5d79e722799c2e08a08
PAMJA	b9727c99c1f75c556cd8e2c804a4b8ee9e2fd2df4eff253f41d8a6f1bdd60bbf

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	40f5422e562118458e79156d0ee6b0f7147c2dd69f0f01cc43fe14faf105ef78
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	3f529bf32420afe1b21bc6d3b8138bcb5df45885bcaf02ba5967dcac0a879fe4
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/40f5422e562118458e79156d0ee6b0f7147c2dd69f0f01cc43fe14faf105ef78>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)

English

ie Këshilli Bashkiak fton Veliajn në mbledhje - Kërkese SPAK-ut dhe Burgjeve për pjesëmarrjenKthiljojne kerkimet arkeologjike ne tshatin GajtanAmbasada Amerikane ne fundit

Këshilli Bashkiak fton Veliajn në mbledhje - Kërkesë SPAK-ut dhe Burgjeve për pjesëmarrjen



25 Shtator 2026, 13:50Sociale TEMA

Këshilli Bashkiak i Tiranës kërkon pjesëmarrjen e kryebashkiakut Erion Veliaj në mbledhjen e 29 shtatorit, e parashikuar të zhvillohet në orën 15:00.

Për këtë qëllim, SPAK-ut dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve u është kërkuar të mundësojnë praninë e tij.

Në shkresë kërkohet që Veliajt t'i jepet leje e përkohshme për të marrë pjesë fizikisht në mbledhje ose, nëse kjo nuk është e mundur, të lidhet online përmes videokonferencës. Sipas kërkesës, pjesëmarrja e kryetarit lidhet edhe me shqyrtimin e çështjeve të administrimit të Tiranës dhe projektligjit për ndarjen administrativo-territoriale.

Këshilli kërkon që institucionet të kthejnë përgjigje me shkrim për vendimmarrjen e tyre.

“Këshilli Bashkiak do të mbledhet ditën e martë, datë 29 shtator 2026, ora 15:00, në sallën e Këshillit Bashkiak, për shqyrtimin, mes të tjerave, edhe të pikës 11 të rendit të ditës, ku detyrimi për t'u shprehur me një qëndrim zyrtar ndaj projektligjit “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, i takon si Kryetarit të Bashkisë Tiranë, ashtu edhe Këshillit Bashkiak të Tiranës.

Nisur nga sa është thënë më sipër dhe referuar vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 66, datë 03.11.2025, por edhe duke qenë se pjesëmarrja e Kryetarit të Bashkisë është një e drejtë funksionale e garantuar me ligj, e nevojshme për prezantimin e drafteve, buxhetit, raportimeve vjetore dhe çështjeve të administrimit të njësive të vetëqeverisjes vendore, ju kërkojmë që, nëse ndaj tij janë duke u zbatuar masa kufizuese, të vlerësohet:

• lejimi i përkohshëm për pjesëmarrje fizike,

Ose, nëse kjo nuk është e mundur,

• mundësimi i pjesëmarrjes së tij nëpërmjet një modaliteti të përshtatshëm komunikimi (online, videokonferencë apo formë tjetër të aprovuar).

Këshilli Bashkiak është i gatshëm të bashkëpunojë plotësisht për çdo kërkesë sigurie, protokolli apo logjistike të institucioneve tuaja, me qëllim garantimin e një procesi ligjor, transparent dhe funksional.

Ju lutemi të na informoni me shkrim mbi vendimmarrjen tuaj, duke patur parasysh rëndësinë e respektimit të funksioneve institucionale dhe të të drejtës së Kryetarit të Bashkisë për të raportuar para Këshillit Bashkiak”, thuhet në kërkesë.



Lënda: Kërkesë për mundësimin e pjesëmarrjes së Kryetarit të Bashkisë Tiranë, z. Erion Veliq, në mbledhjen e Këshillit Bashkiak të datës 29 shtator 2026

Z. KLODIAN BRAHO

STRUKTURËS SË POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR

ZADRIATIK KUPI

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË BURGJEVE

Të nderuar përfaqësues të institucioneve,

Këshilli Bashkiak i Tiranës, në zbatim të detyrimeve të tij ligjore dhe me qëllim garantimin e funksionimit të rregullt institucional, ju drejtohet për të kërkuar mundësimin e pjesëmarrjes së Kryetarit të Bashkisë Tiranë, z. Erion Veliq, në mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak, e cila do të zhvillohet ditën e martë, në datë 29 shtator 2026, ora 15:00, në ambientet e Bashkisë Tiranë.

Sipas Ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, konkretisht:

- Neni 58 pika 4, përcakton se Kryetari i Bashkisë ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet e Këshillit Bashkiak dhe të raportojë.
- Neni 60, përcakton bashkëpunimin e detyrueshëm ndërmjet Kryetarit të Bashkisë dhe Këshillit Bashkiak, për çështje të interesit publik.

Me shkresë nr.28257 prot, datë 03.08.2026, Kuvendi i Shqipërisë ka përcjellë pranë Bashkisë Tiranë dhe Këshillit Bashkiak, projektligjin "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësisë të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", ku kërkohet shprehja e pëlqimit lidhur me propozimin e bërë nga një grup i anëtarëve të Komisionit të Posaçëm të Reformës Administrativo- Territoriale për bashkinë Tiranë.

Bazuar në ligjin 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, neni 90, pika 3, Bashkia Tiranë dhe Këshilli Bashkiak kanë 60 ditë afat për shprehjen e qëndrimit të tyre ndaj projektligjit të propozuar.

Në zbatim të këtij afati ligjor, Këshilli Bashkiak do të mbledhet ditën e martë, datë 29 shtator 2026, ora 15:00, në sallën e Këshillit Bashkiak, për shqyrtimin, mes të tjerave, edhe të pikës 11 të rendit të ditës, ku detyrimi për t'u shprehur me një qëndrim zyrtar ndaj projektligjit "Për ndarjen administrativo- territoriale të njësisë të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", i takon si kryetarit të Bashkisë Tiranë, ashtu edhe Këshillit Bashkiak të Tiranës.

Nisur nga sa është thënë më sipër dhe referuar vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr.66, datë 03.11.2025, por edhe duke qenë se pjesëmarrja e Kryetarit të Bashkisë është një e drejtë funksionale e garantuar me ligj, e nevojshme për prezantimin e drafteve, buxhetit, raportimeve vjetore dhe çështjeve të administrimit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, ju

Kërkojmë që, nëse ndaj tij janë duke u zbatuar masa kufizuese, të vlerësohet:

- lejimi i përkohshëm për pjesëmarrje fizike,

Ose, nëse kjo nuk është e mundur,

- mundësimi i pjesëmarrjes së tij nëpërmjet një modaliteti të përshtatshëm komunikimi (online, videokonferencë apo formë tjetër të aprovuar)

Këshilli Bashkiak është i gatshëm të bashkëpunojë plotësisht për çdo kërkesë sigurie, protokolli apo logjistike të institucioneve tuaja, me qëllim garantimin e një procesi ligjor, transparent dhe funksional.

Ju lutemi të na informoni me shkrim mbi vendimmarrjen tuaj, duke patur parasysh rëndësinë e respektimit të funksioneve institucionale dhe të të drejtës së Kryetarit të Bashkisë për të raportuar para Këshillit Bashkiak.

Me respekt,

Këshilltarët

Julian Halaj
Enxhet Haxha

Glindiret Hadhi

Alire Muharezi Zoliku

Silda ÇEPE

AGIM KARA

Megj. Fino

Sare Shauveti

Grejsi Bixhi

Rezart Isufi

Halit Valtari

Jemo Hysa

JOLEZA KOKA

Enxhet Shauveti

Braxhinda Koto

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

Rregulla të reja në "Schengen"! Gjermania ul kuotën për punëtorët e huaj, preken dhe shqiptarët

12:30 Sociale



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.